



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 217/5 Prot.

Tiranë, më 02/05/2023

URDHËR

Nr. 314, Datë 02/05 2023

**“PËR HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT
KLEMENT RADOVANI”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja “ë”, dhe nenit 67, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ:

Me Urdhrin nr. 134, datë 01.02.2023 të Ministrit të Drejtësisë është vendosur fillimi i hetimit administrativ për mosushtrimin e veprimtarisë noteriale nga noteri Klement Radovani, pasi pranë Ministrisë së Drejtësisë, janë administruar një sërë ankesash, konkretisht ankesa me nr. A-260 prot., datë 16.06.2021, nr. Xh-52 prot., datë 20.07.2022, e-maili i datës 24.11.2022, ku shtetas të ndryshëm pretendojnë se, janë paraqitur pranë zyrës noteriale të noterit Klement Radovani dhe nuk arrijnë të marrin shërbimin noterial të kërkuar, pasi zyra e tij gjendet e mbyllur.

Nga Ministria e Drejtësisë është kërkuar informacion nga noteri në rrugë shkresore dhe elektronike lidhur me ankesat e administruara pranë Ministrisë së Drejtësisë, apo për zbatimin e detyrave të tij në cilësinë e kryetarit të Degës Vendore të Noterisë Shkodër por nuk është administruar asnjë përgjigje nga ana e tij. Ndërkohë, njoftimet e dërguara në rrugë shkresore rezultojnë të jenë kthyer nga shërbimi postar me shënimin “larguar”.

Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 134, datë 01.02.2023, grupi i kontrollit u paraqit për kontroll në zyrën e noterit Klement Radovani, në adresën e deklaruar prej tij, për ushtrimin e veprimtarisë noteriale “Lagjja “Qemal Stafa”, rruga “Don Bosko”, Shkodër, ku nga verifikimet e kryera nga grupi kontrollit rezultoi se:

Zyra noteriale e deklaruar nga noteri Klement Radovani, në adresën “Lagjja: “Qemal Stafa”, Rruga: “Don Bosko” për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, nuk u gjend. Në këtë adresë ku më parë ka ushtruar veprimtarinë noteriale z. Klement Radovani, nuk ka asnjë tabelë informuese me emrin e noterit apo të faktit se, në këtë zyrë ushtrohet veprimtari noteriale.

Nga grupi i kontrollit u konstatua se, tashmë në këtë zyrë ushtronte veprimtarinë e avokatisë, avokati z. G.H, prej të cilit u deklarua se ka filluar ushtrimin e avokatisë në këtë zyrë në muajin tetor 2022. Grupi i kontrollit administroi foto të zyrës, brenda dhe jashtë saj dhe konstatoi se, brenda zyrës nuk kishte asnjë material të ushtrimit të veprimtarisë nga noteri dhe sipas deklaratës së avokatit G.H, arkivën e noterit Klement Radovani e ka tërhequr i biri i tij në periudhën tetor 2022, kur është liruar edhe zyra.

Ndodhur në kushtet kur, pranë Ministrisë së Drejtësisë nga ana e noterit Klement Radovani nuk është paraqitur asnjë kërkesë për pezullim të veprimtarisë noteriale, sipas parashikimeve të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, kemi kërkuar informacion të vazhdueshëm nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, nëse noteri Klement Radovani ka paraqitur pranë saj kërkesë duke parashtruar arsye të përligjura për mosushtrimin e veprimtarisë së tij noteriale dhe nëse po, cili ka qenë qëndrimi zyrtar i mbajtur nga Dhoma Kombëtare e Noterisë. Ky informacion është kërkuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë fillimisht në rrugë shkresore, si dhe elektronike, konkretisht me shkresën nr.A-250/2 prot., datë 02.07.2021 dhe së fundmi me email-in e datës 24.05.2022 dhe nuk ka patur asnjë përgjigje nga ana e tyre për këtë rast.

Nga verifikimi i realizuar në sistemin e Regjistrimit Noterial Shqiptar, rezulton se veprimi i fundit i regjistruar në sistem është me numër serial 2020-00000120, nr. 121 rep., nr. 56 kol., datë shërbimi 06.05.2020 dhe është regjistruar (arkivuar) në sistem në datën 12.05.2020.

Në nenin 18, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, përcaktohen ndër të tjera, rastet kur noteri mund të kërkojë pezullimin, afatet e pezullimit, si dhe autoritetin që ka kompetencën për pranimin e kërkesës për pezullim. Referuar kësaj dispozite parashikohet detyrimi për paraqitjen e kërkesës për pezullim, Ministrit të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, dhe është Ministri i Drejtësisë ai që vendos për pranimin ose refuzimin e argumentuar të kërkesës për pezullimin e përkohshëm të licencës së noterit, duke marrë në konsideratë edhe mendimin e Dhomës.

Nga verifikimi i kryer, rezulton që noteri Klement Radovani nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë noteriale, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi.

Bazuar në sa më sipër, duke iu referuar edhe veprimit të fundit të realizuar nga noteri Klement Radovani në RNSH, datë 12.05.2020, konstatohet se noteri ka gati 3 vjet që nuk ofron shërbim noterial ndaj publikut, pa miratimin e Ministrit të Drejtësisë.

Si përfundim, referuar rrjedhës kronologjike të fakteve të sipërcituara, si dhe parashikimeve të nenit 63, pika 1, gërma “m”, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar, ku përcaktohet se, *“Noteri, përveç detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në ligje të veçanta, kryen detyrat e mëposhtme...siguron mbajtjen hapur të zyrës noteriale, sipas rregullave të miratuara për këtë qëllim”*, në harmoni me parashikimet e nenit 21, për rastet e heqjes së licencës, konkludojmë se, pavarësisht të gjitha instrumentave ligjore që ka patur ky subjekt, me neglizhencë apo vetëveprim ka sjellë si pasojë, braktisjen e detyrës.

Rezulton se, noteri Klement Radovani është në kushtet e braktisjes së detyrës sipas parashikimeve të nenit 63, pika 1, gërma “m” ku citohet se: *“Noteri, përveç detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj dhe në ligje të veçanta, kryen detyrat e mëposhtme...siguron mbajtjen hapur të zyrës noteriale, sipas rregullave të miratuara për këtë qëllim”*.

Gjithashtu në pikën 1, gërma “ë”, të nenit 21, të ligjit nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, parashikohet se: *“1. Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri... ë) nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohe deri në 60 ditë rresht pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrinë e Drejtësisë,*

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të gërmës “ë”, të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Klement Radovani, anëtar i Degës Vendore të Noterisë Shkodër, pasi nuk ushtron veprimtarinë noteriale për një periudhë kohore gati tre vjet, pa shkak të arsyeshëm, të dokumentuar dhe të njoftuar me shkrim pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a.) Dy përfaqësues nga Sektori i Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b.) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Shkodër;
 - c.) Një përfaqësues i caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë.
3. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit Klement Radovani, nga komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, bankat e nivelit të dytë.
5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterial, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

6. Dega Vendore e Noterisë Shkodër dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijeni e këtij urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar.
7. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 6, të këtij urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës, noterit të përcaktuar nga dega vendore përkatëse e noterisë.
8. Ndaj këtij urdhri, noteri mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të tij.
9. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.
10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore e Noterisë Shkodër, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.
11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, për njoftimin e këtij urdhri noterit Klement Radovani, Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Degës Vendore të Noterisë Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI



Ulsi Manja

